VENDIM
Nr.992, datë 15.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR.208, DATË 24.3.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE QEVERISË SË KOSOVËS, PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË PROPOZUARA PËR KOMUNËN GRAÇANICË, KOSOVË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.208, datë 24.3.2010 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim dhe kjo shtesë:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Kundërvlefta në lekë për 200 000 (dyqind mijë) euro t'i shtohet buxhetit të miratuar për vitin 2010, për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për t'u përdorur në formën e transfertës.".

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Fondet e pashpenzuara prej 200 000 (dyqind mijë) eurosh nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, për vitin 2010, të përdoren nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për rimbursimin e TVSH-së për kontratat e financuara nga IPA-ja, 2008.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha